



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

KRYETARI

Nr. 2350 Prot.

Lezhë, më 18.02.2026

Nr. _____ Datë 18.02.2026

PROJEKT-VENDIM

“PËR MIRATIMIN E PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR TË NËPUNËSVE CIVILË, TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË TË PUNONJËSVE MBËSHTETËS DHE TË MASËS SË SHPËRBLIMIT MUJOR TË KËSHILLTARËVE DHE KRYETARËVE TË FSHATRAVE”

Në mbështetje të nenit 54, ligjit nr.139 /2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, të ligjit nr.35 datë 25.05.2023 “Për kompetencat në caktimin e pagave dhe shpërblimeve, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të punësuarve në insitucionet e administratës publike, si dhe të pagës minimale në shkallë vendi”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.328 datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijeve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.103, datë 11.02.2026 “Për disa ndryshime në vendimin nr.328, datë 31.05.2026 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijeve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.326 datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike”, i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave me nr.87 datë 06.02.2026, “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.326 datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 776 datë 19.12.2025 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” Ligji 29/2023, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit Bashkiak me nr. 113 datë 15.12.2025 “Për miratimin e Programit Buxhetor 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor për vitin 2026”, Urdhërit me nr. 136, datë 16.02.2026 të Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e strukturës, organikës, emërtimet e pozicioneve, klasat për çdo pozicion pune për administratën e bashkisë , të njësive administrative, të institucioneve vartëse dhe të punonjësve të njësive të shërbimeve për vitin 2026”, Kryetari i Bashkisë i paraqet Projekt-Aktin Këshillit të Bashkisë,

PËR TË VENDOSUR:

1. Miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë, të punonjësve administrativë, të punonjësve mbështetës dhe të masës së

- shpërblimit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave, sipas Lidhjes nr.1, 2 dhe 3, bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij vendimi.
2. Shpërblimi mujor i këshilltarëve për funksionin që kryejnë të jetë në masën 10 % të pagës së kryetarit të bashkisë.
 3. Shpërblimi mujor i kryetarëve të fshatrave për veprimtarinë që kryejnë të jetë si më poshtë :
 - Në fshatrat deri në 1000 banorë, 2.5 % e pagës së Kryetarit të Bashkisë Lezhë.
 - Në fshatrat 1001 – 2000 banorë, 3 % e pagës së Kryetarit të Bashkisë Lezhë.
 - Në fshatrat 2001 – 3000 banorë, 3.5 % e pagës së Kryetarit të Bashkisë Lezhë.
 - Në fshatrat 3001 – 4000 banorë, 4 % e pagës së Kryetarit të Bashkisë Lezhë.
 - Në fshatrat mbi 4000 banorë, 4.5 % e pagës së Kryetarit të Bashkisë Lezhë.
 4. Shtesa për vjetërsi në punë jepet në masën:
 - 0.6 % pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1-10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.
 - 0.8 % pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (10-20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.
 - 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e e treta (21-30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.
 5. Specialistët e IT, në Sektorin e Programim Zhvillimit, Komunikimit dhe Transparencës, në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës, në Bashkinë Lezhë të trajtohen më shtesë për kushte pune (natyrë të veçantë pune) me vlerën 7,500 lekë në muaj.
 6. Vendimi nr. 74 datë 25.09.2024, i Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për miratimin e pagave të funksionarëve, të zgjedhurve dhe të emëruar, të nëpunësve civilë, të punonjësve administrativë, të punonjësve mbështetës dhe të masës së shpërblimit mujor të këshilltarëve dhe të kryetarëve të fshatrave”, i ndryshuar, shfuqizohet.
 7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
 8. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.
 9. Efektet financiare të këtij vendimi shtrihen nga data 01.01.2026.

KRYETARI
Pjerin Ndreu



Lidhja nr.1 -Niveli i pagës për funksionarët dhe nëpunësit civilë në Bashkinë Lezhë

Nr.	Emërtimi i pozicionit të punës për çdo kategori	Kategoria	Grupi i diplomes	Paga e Grupit	Paga për Pozicion
1	Kryetari i Bashkisë	-	-	-	260,000
2	Zëvendëskryetar i Bashkisë	-	-	-	205,000
3	Administrator në Njësitë Administrative me 5001-20000 banorë	-	-	-	145,000
4	Administrator në Njësitë Administrative nën 5000 banorë	-	-	-	140,000
5	Sekretar i Përgjithshëm	I-4	1	14,000	180,000
6	Sekretar i Këshillit Bashkiak	I-5	1	14,000	170,000
7	Drejtor Kabineti	I-5	1	14,000	170,000
8	Këshilltar Juridik	II-2	1	14,000	120,000
9	Këshilltar i Kryetarit	II-2	1	14,000	100,000
10	Sekretar i Kryetarit	IV-4		14,000/12,000 / 10,000	60,000
11	Drejtor	II-2	1	14,000	141,000
12	Përgjegjës Sektori 1/ Menaxher Shërbimesh	III-2	1	14,000	105,000
13	Përgjegjës Sektori 2	III-3	1	14,000	98,000
14	Specialist 1	IV-2	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	80,000
15	Specialist 2	IV-3	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	70,000
16	Specialist 3	IV-4	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	60,000
17	Kryeinspektor i Policisë Bashkiake	III-2	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	105,000
18	Kryeinspektor i IVMT	III-3	1	14,000	105,000
19	Inspektor i IVMT	IV-3	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	80,000
20	Përgjegjës Njësie	IV-3	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	70,000
21	Specialist në Qëndrat Kulturore	IV-4	1 ose 2 ose 3	14,000/11,000 / 10,000	60,000

22	Specialist Pyjesh/Inspektor pyjesh	IV-4	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	60,000
23	Specialist Logopedist	IV-4	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	60,000
24	Specialist Fizioterapist	IV-4	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	60,000
25	Specialist Punonjës Social	IV-4	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	60,000
26	Specialist Protokoll-Arkive-Sekretari	IV-4	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000 / 10,000	60,000
27	Psikolog	IV-3	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000/10,000	70,000
28	Punonjës Social për Njësinë e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave	IV-3	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000/10,000	70,000
29	Punonjës Social për Fëmijë dhe të Rritur	IV-3	1 ose 2 ose 3	14,000/12,000/10,000	70,000
30	Mësues për Shërbimin Edukativ(me kohë të pjesshme)	Me kohë të pjesshme			38,000
31	Edukatore për Shërbimin Ditor/Parashkollor(me kohë të pjesshme)	Me kohë të pjesshme			38,000
32	Menaxheri Projekti "Projekti ProLIGHTMED"	VKB-së nr. 50 datë 28.06.2024 "Për miratimin e marrëveshjes së përbashkët ndërmjet Komunës së Tuzit dhe Bashkisë Lezhë			100,000
33	Koordinator Projekti, për Projektin Urbact Pioners	Paga sipas Kontratës së Subvencionit për Lezha Urbact Pioneers Aceelerator			70,000

Lidhja nr.2 -Niveli i pagës për punonjësit administrative

Nr.	Emërtimi i pozicionit të punës	Paga për pozicion	Shtesë Vjetërsie	Punë të vështira e të dëmshme për shëndetin
1	Sanitare	51,000	1%	2,000
2	Punonjës Kontrolli Higjene	53,000	1%	
3	Punonjës Informacioni	57,000	1%	
4	Koordinator	54,000	1%	

5	Inspektor Terreni per Emergjencat Civile	54,000	1%	
6	Psikolog	54,000	1%	
7	Punonjës Protokoll-Arkive-Sekretari	57,000	1%	
8	Arkëtar në Njësitë Administrative	57,000	1%	
9	Shofer administrate	57,000	1%	2,000
10	Magaznier	56,000	1%	
11	Fotograf	57,000	1%	
12	Punonjës i Policisë Bashkiake	57,000	1%	
13	Kostomugraf	57,000	1%	
14	Përgjegjës Njësie	57,000	1%	
15	Përgjegjës Çerdheje	57,000	1%	

Lidhja nr.3 -Niveli i pagës për punonjësit mbështetës

Nr.	Emërtimi i pozicionit të punës	Paga për pozicion	Shtesë Vjetërsie	Punë të vështira e të dëmshme për shëndetin	Për natyrë të veçantë pune
1	Punonjës me Kontratë	51,000	1%	2,000	
2	Sanitare	51,000	1%	2,000	
3	Punëtor Shërbimesh	51,000	1%	2,000	
4	Punëtor Pastrimi të Rrugëve dhe Trotuareve	51,000	1%	2,000	
5	Roje Pyjesh	52,000	1%		
6	Roje	52,000	1%		
7	Shofer	53,000	1%	2,000	
8	Kujdestare	56,000	1%		
9	Ndihmës Kuzhinierë	53,000	1%		
10	Pjatararëse	53,000	1%		
11	Teknik Pyjesh	54,000	1%		
12	Fizioterapist	55,000	1%		
13	Kuzhinier	55,000	1%		
14	Agronom	55,000	1%		
15	Mekanik	55,000	1%	2,000	
16	Marangoz	55,000	1%	2,000	
17	Manovrator	55,000	1%	2,000	
18	Hidraulik	55,000	1%	2,000	
19	Bojaxhi	55,000	1%	2,000	
20	Hidroizolues	55,000	1%	2,000	
21	Murator	55,000	1%	2,000	
22	Saldator	55,000	1%	2,000	
23	Kaldaist	55,000	1%	2,000	
24	Teknik/Teknik Ndërtimi	56,000	1%	2,000	
25	Elektriçist	56,000	1%	2,000	
26	Teknik (Përgjegjës Grupi)	57,000	1%		
27	Shofer Ekologjik	57,000	1%	2,000	4,000
28	Punëtor Ekologjik	55,000	1%	2,000	4,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMËVE MBËSHTETËSE

Nr. 2350/ Prot.

Lezhë, më 18.02 2026

RELACION
PËR
PROJEKT-VENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR TË NËPUNËSVE CIVILË, TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË TË PUNONJËSVE MBËSHTETËS DHE TË MASËS SË SHPËRBLIMIT MUJOR TË KËSHILLTARËVE DHE KRYETARËVE TË FSHATRAVE”

Në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “ç”, nenit 55, pika 2, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, nenit 6, shkronja “c” dhe nenit 9, të ligjit nr.35/2023, datë 25.05.2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr. 328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.103, datë 11.02.2026 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.328, datë 31.05.2026 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijeve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr.326 datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike”, i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave me nr.87 datë 06.02.2026, “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.326 datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike, Ligji 29/2023, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 776 datë 19.12.2025 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, të VKB-së nr. 113 datë 15.12.2025 “Për miratimin e Programit Buxhetor 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor për vitin 2026”, Urdhërit nr.136 datë 16.02.2026 të Kryetarit të Bashkisë “Për

miratimin e strukturës, organikës , emërtimet e pozicioneve, klasat për çdo pozicion pune për administratën e bashkisë , të njësive administrative, të institucioneve vartëse dhe të punonjësve të njësive të shërbimeve për vitin 2026”, Kryetari i Bashkisë i parashtron Projekt-Aktin, Këshillit Bashkiak, sa më poshtë vijon:

Në kuadër të ndryshimeve në legjislacionin e pagave, konkretisht ndryshimit të vendimit nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijëve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.103, datë 11.02.2026 “Për disa ndryshime në vendimin nr.328, datë 31.05.2026 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijeve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar të nëpunësve civil e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe VKM-së nr. 776 datë 19.12.2025 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Shërbimeve Mbështetëse ka pasqyruar ndryshimet në nivelin e pagave të punonjësve administrativë dhe të punonjësve mbështetës të Bashkisë Lezhë, në këtë Projekt-Vendim.

Një ndër ndryshimet kryesore të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 328 datë 31.05.2023, i ndryshuar, konsiston në procesin për reformën e pagës minimale në shkallë vendi nga 40,000 mijë lekë të bëhet 50,000 mijë lekë.

Këshilli Bashkiak bazuar në shkronjën “a” të nenit 9 të ligjit 35/2023 ka kompetencën për caktimin e pagave, përfshirë të gjithë elementet përbërës si: paga bazë, paga për pozicion, shtesa për vjetërsi, shtesa për vështirësi, shtesa për kushte pune, me qëllim garantimin e shpërblyerimit të drejtë e të barabartë të punësuarve si dhe motivimin dhe rritjen e performancës në punë.

Në pikën 1 të projekt-vendimit, bazuar në pikën ç , nenin 54, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, është paraqitur për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil, të punonjësve administrativ, të punonjësve mbështetës.

Në praktikë për pjesën e punonjësve administrativ dhe punonjësve mbështetës, pra të sistemit me klasa, për të qenë në koherencë me vendimet e qeverisë dhe për të garantuar barazi në paga si në pushtetin qendror me atë vendor, duke qenë se pati ndryshim të pagës minimale, referuar ndryshimeve të fundit në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 776 datë 19.12.2025 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr. 328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijëve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, kufijët e pagave bazë të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore të jenë nga 50,000- 57,000 lekë në muaj. Si dhe referuar Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr.326, datë 31.05.2023, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, për disa kategori punonjësish të cituar në lidhjen 1 dhe 2 përfitojnë shtesë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin në masën 2000 (dy mijë) lekë në muaj dhe shtesë për natyrë të veçantë pune në masën 4000 (katër mijë) lekë në muaj

Në Lidhjen nr.2 propozohet niveli i pagës për punonjësit administrativ në të cilën përcaktohet paga bazë, shtesa për vjetërsi në punë në masën 1 % deri në 25 vite pune e cila jepet mbi pagën bazë mujore të klasës përkatëse si dhe shtesa **për vështirësi pune** në masën 2,000 (dy mijë) lekë në muaj. Në Lidhjen nr.3 propozohet niveli i pagës për punonjësit mbështetës në të cilën përcaktohet paga bazë, shtesa për vjetërsi në punë në masën 1 % deri në 25 vite pune e cila jepet mbi pagën bazë mujore të klasës përkatëse si dhe shtesa **për kushte pune** në masën 2,000 (dy mijë) lekë në muaj dhe **për natyrë të veçantë pune** në masën 4,000 (dy mijë) lekë në muaj. Propozimet e paraqitura për rritje e pagavë të punonjësve administrativ dhe të punonjësve mbështetës e përfitojnë **315 punonjës**.

Në pikën 2 të projekt-vendimit, bazuar në nenin 51, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, është paraqitur për miratim shpërblimi mujor i këshilltarëve të Këshillit Bashkiak të Lezhës në masën 10% të pagës mujore të Kryetarit të Bashkisë.

Aplikimi i pagës sipas lidhjeve të mësipërme do të fillojë nga data 1 Janar 2026 dhe efektet financiare të rritjes së pagave (paga + sigurime shoqërore) do të përballohen nga buxheti i vitit 2026 i miratuar me Vendimit të Këshillit Bashkiak me nr. 113 datë 15.12.2025 “Për miratimin e Programit Buxhetor 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor për vitin 2026”.

Për sa më sipër kërkojmë nga Këshilli Bashkiak, në cilësinë e organit vendimmarrës miratimin e projekt-vendimit “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar të nëpunësve civil të punonjësve administrativ dhe të punonjësve mbështetës të masës së shpërblimit mujor të këshilltarve dhe të kryetarve të fshatrave”, të Bashkisë Lezhë.

KRYETARI

Pjerin Ndreu

